

Njoftim i përqendrimit me të cilin Milija Babović Serbia dhe Maden Jurop Holding, B.V. Holandë do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi SM Feshn doo Beograd, Serbi

(lënda nr. 08-94/2024

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 01.06. 2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilën Milija Babović, shtetase e Republikës së Serbisë, dhe Maden Jurop Holding, B.V., me seli në Touvslager 12, 5253 RK Nievkujk, Amsterdam, Holandë synojnë të fitojnë kontroll të përbashkët direkt mbi SM Feshn doo Beograd, me seli në Bulevardin Mihaila Pupina 115B, Beograd, Republika e Serbisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit

Milija Babović është një investitore private që jeton në Republikën e Serbisë.

Në Maqedoninë e Veriut, Milija Babović, në mënyrë indirekte, ka një shoqëri të varur të regjistruar – Shoqëri për tregtinë me shumicë dhe pakicë të tekstileve dhe produkteve tekstile EUROFESHN TREJD DOO import-eksport Shkup, shoqëri e organizuar në përputhje me ligjet e Maqedonisë së Veriut, me seli të regjistruar në rr. Nikolla Klusev nr. 6, kati 7, Shkup, me aktivitet të regjistruar të tregtisë me pakicë të veshjeve në dyqane të specializuara.

Aktiviteti kryesor i **Maden Jurop Holding, B.V.** është dizajnimi dhe shitja e produkteve nga marka të ndryshme për shitës të ndryshëm me pakicë.

Maden Jurop Holding, B.V. nuk ka asnjë shoqëri të lidhur të regjistruar në Maqedoninë e Veriut.

Aktiviteti prioritar i **SM Feshn doo Beograd** është tregtia me shumicë e pa specializuar.

SM Feshn doo Beograd nuk ka asnjë shoqëri të lidhur të regjistruar në Maqedoninë e Veriut.

Parashtruesi i njoftimit konsideron se tregjet përkatëse për përqendrimin në fjalë mund të përkufizohen si: 1) tregu i tregtisë me pakicë i veshjeve, këpucëve dhe aksesorëve të modës në dyqane të specializuara dhe 2) tregtia me pakicë i veshjeve, këpucëve dhe aksesorëve të modës përmes postës dhe internetit. Shtrirja e saktë gjeografike e tregut është të paktën kombëtare ose më e gjerë se ajo kombëtare, por përkufizimi i tregut përkatës gjeografik mund të lihet i hapur.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

19.06.2024

Shkup

